



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 6 tetor 2023  
Nr.ref.: RK 2282/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI206/22**

Parashtrues

**Alush Hoti, Haxhi Hoti dhe Ruzhdi Hoti**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev.nr. 160/2022, të 24 gushtit 2022**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar.

#### **Parashtruesit e kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Alush Hoti, Haxhi Hoti dhe Ruzhdi Hoti, me vendbanim në fshatin Samadrexhë, në komunën e Suharekës, të cilët i përfaqëson avokati Ekrem Agushi, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [Rev.nr. 160/2022] e 24 gushtit 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.3543/2018] e 3 shkurtit 2022, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr. 578/2014] e 19 prillit 2018, të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë (Në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 21 dhjetor 2022, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).
7. Më 30 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR.KI206/22] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi Peci-gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr.KSH.KI206/22] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.
8. Më 6 janar 2023, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
9. Më 25 janar 2023, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 25 janar 2023, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.

11. Më 31 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

12. Më 11 dhjetor 2014, parashtruesit e kërkesës paraqitën padi kundër të paditurës Komuna e Suharekës, për shkak të vërtetimit të drejtës së pronësisë, në bazë të mbajtjes - parashkrimit fitues, në paluajtshmërinë kontestuese (pjesën e njësisë kadastrale 00957 -0, e regjistruar në certifikatën pronësore [nr.952-0] filluar nga muri ekzistues i ndërtuar para më tepër se 80-90 vite).
13. Më 19 prill 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr. 578/2014]: (I) aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, duke vërtetuar se të njëjtit në bazë "të mbajtjes-parashkrimit fitues janë bashkëpronar: me nga 1/3 të pjesës së ngastrës kadastrale 957-0 ZK Samadrexhë, në vendin e quajtur "Fshat" në: sipërfaqen prej 46 m<sup>2</sup>, me kulturë rrugë e pa kategorizuar, me dimension dhe kufi, në gjatësi nga ana lindore prej 1.10 m nga ana perëndimore 1.52 m, nga ana veriore në vijë të lakuar 28.38 m dhe nga ana jugore 28.74 m; dhe obligoi të paditurën- *Komunën e Suharekës* t'ia pranojë këtë të drejtë parashtruesve të kërkesës dhe që kjo pjesë e paluajtshmërisë të regjistrohet në librat kadastrale të Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër në Suharekë si bashkëpronësi me nga 1/3 e pjesëve ideale në emër të parashtruesve të kërkesës dhe atë brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi; (II) obligohet e paditura-Komuna e Suharekës, që parashtruesve të kërkesës t'ua paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 1.543 €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm."
14. Në një datë të paspecifikuar, përfaqësuesi i të paditurës – Komuna e Suharekës, dorëzoi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur, për shkak të (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatimit të gabuar të të së drejtës materiale, me propozimin që ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe ta kthejë çështjen në rigjykim, ose të vendoset në mënyrë meritore, ku padia dhe kërkesëpadia të refuzohet në tërësi si e pabazuar.
15. Më 3 shkurt 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [A.C.nr.3543/2018]: (I) aprovoi si të bazuar ankesën e të paditurës – Komuna e Suharekës, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore [C.nr.578/2014] i 19 prillit 2018, dhe gjykohet si në vijim: (II) refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës, me të cilën kishin kërkuar që të vërtetohet se parashtruesit e kërkesës në bazë të mbajtjes - parashkrimit fitues janë bashkëpronar me nga 1/3 të pjesës së ngastrës kadastrale [957-0 ZK Samadrexhë], në vendin e quajtur "Fshat", në sipërfaqe prej 46 m<sup>2</sup>, me kulture rrugë e pa kategorizuar, me dimensione dhe kufi, në gjatësi nga ana lindore prej 1.10m nga ana perëndimore 1.52m, nga ana veriore në vije të lakuar 28,38 m, dhe nga ana jugore 28.74 m, dhe obligohet e paditura Komuna e Suharekës, t'ia pranojë këtë të drejtë parashtruesve të kërkesës dhe që kjo pjesë e paluajtshmërisë të regjistrohet në librat kadastrale të Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër në Suharekë si bashkëpronësi me nga 1/3 e pjesëve ideale në emër të tyre dhe atë brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.
16. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi si në vijim: *Gjykata e shkallës së dytë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për faktin se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vështron sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit*

*nr.3/L-006 për procedurën kontestimore. Gjendja faktike nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, mirëpo gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale dhe për këtë arsye aktgjykimi është ndryshuar dhe kërkesëpapia e parashtruesve të kërkesës refuzohet si e pabazuar e në bazë të nenit 195/1 nën pikën e), e lidhur me nenin 201 par.1 nën pikën d), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.*

17. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesë për revizion, për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet revizioni dhe aktgjykimi i goditur të ndryshohet ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet ose aktgjykimi i goditur me revizion të prishet dhe çështja ti kthehet në rigjykim Gjykatës së Apelit.
18. Më 24 gusht 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr. 160/2022] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesve të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.3543/2018] të 3 shkurtit 2022. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme theksoi si në vijim:

*"[...] Në kontekstin e mësipërm, paditësit nuk kanë provuar se e kanë fituar pronësinë në bazë të parashkrimit fitues (Usucapio - neni 28 i LMTHPJ-së), përkatësisht, sikundër kanë pretenduar, se me mbajtje dhe posedim me mirëbesim mbi 20 vite e kanë fituar pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese.*

*[...]*

*nuk mund të bëhet fjalë për posedimin me mirëbesim e me këtë as për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues sikundër parashihet me dispozitën e nenit 28.4 të Ligjit të sipër përmendur, sipas të cilës, përveç posedimit të sendit dhe kohëzgjatjes së posedimit prej 20 viteve, kërkohet që posedimi të jetë edhe me mirëbesim, gjë që, siç u sipër theksua, këtu nuk është rast.*

*[...]*

*Në kontekstin e mësipërm, duhet pasur parasysh se edhe me dispozitën e nenit 11 të Ligjit për rrugët, nr.2003/11, parashihet se "Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike".*

### **Pretendimet e parashtruesve të kërkesës**

19. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i kontestuar, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
20. Parashtruesit e kërkesës lidhur me pronën e paluajtshme të kontestuar, në thelb ngritin pretendime të vendimit të paarsyetuar gjyqësor, duke sfiduar qëndrimin e gjykatave të rregullta për sa i përket konstatimit se paluajtshmëria është në pronësi të paditurës, përkatësisht Komunes së Suharekës, me ç' rast konsiderojnë se ky konstatim "[...] është kundërthënës me përmbajtjen e vërtet të provave të shqyrtuara, me arsyetim se vetëm akti i regjistrimit të paluajtshmërisë në pronësi të paditurës, i cili nuk është i bazuar në ndonjë dokument juridik - titull juridik, sikurse është përcaktuar me Rregullat e Përgjithshme Pasurore, të cilat kanë qenë të zbatueshme në ish Jugosllavi dhe në territorin e ish KSA të Kosovë dhe dispozitat e nenit 20 AL.1 dhe 2 të Ligjit për

*Marrëdhëniet Pronësoro Juridike Bazë (Ligj i zbatueshëm në Kosovë prej vitit 1980) nuk përfaqëson bazë ligjore për fitim të së drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese nga ana e të paditurës.”*

21. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme gjatë procedurës së gjyqimit të kësaj çështje kontestimore kanë bërë shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me nenin 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
22. Përfundimisht parashtruesit e kërkesës theksojnë që: “[...] aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilët paditësit i është refuzuar kërkesëpadia si e pabazuar nuk i kanë respektuar standardet kushtetuese të arsyetimit të aktgjyqimeve e tyre dhe për këto arsye paditësit vlerësojnë se gjykatat e cekura më lartë kanë bërë shkelje të dispozitave nga neni 31 të Kushtetutës dhe neni 6 të Konventës Evropiane - e drejta për një proces të rregullt.”

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

### **Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ e RSFJS-ë, 8 shkurt 1980)**

#### **2. Fitimi i së drejtës së pronësisë**

#### **Neni 20 (pa titull)**

*E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.*

*E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.*

#### **Neni 28 (pa titull)**

*[...]*

*Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.*

### **Neni 33 (pa titull)**

*Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.*

### **Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët**

### **Neni 11 (pa titull)**

*Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

23. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

25. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

### **Neni 47 (Kërkesa individuale)**

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”*

*[...]*

### **Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)**

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

### **Neni 49 (Afatet)**

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

26. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, që kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr. 160/2022] e 24 gushtit 2022, të Gjykatës Supreme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendojnë se u janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

27. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 34 (2) parasheh:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*

28. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

29. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuzë dhe të paqarta”.

30. Në këtë kontekst, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

31. Në dritën e këtij sfondi normativ, Gjykata sjell në vëmendje se çështja thelbësore në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të së drejtës së mbajtjes (parashkrimit fitues) dhe shfrytëzimit të pronës për një kohë të gjatë, të cilën ngastër pretendonte se e kishin trashëguar nga paraardhësit e tyre. Fillimisht, Gjykata Themelore e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës për vërtetimit e të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vendim ky i cili u atakua nga e paditura- Komuna e Suharekës. Në procedurat vijuese, Gjykata e Apelit miratoi si të bazuar ankesën e



Komunës së Suharekës, duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës. Përfundimisht, pas kërkesës për revizion të parashtruesve të kërkesës, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesve të kërkesës duke konkluduar se të njëjtit nuk e kanë provuar se e kanë fituar pronësinë në bazë të parashkrimit fitues, sikurse kishin pretenduar se me mbajtje me mirëbesim mbi 20 vite e kishin fituar pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese.

32. Gjykata, duke iu rikthyer shqyrtimit të kërkesës rikujton se parashtruesit e kërkesës para Gjykatës pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së. Duke iu referuar shkresave të lëndës, Gjykata vëren se esenca e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, ka të bëjë me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, e cila ndërlihet me mungesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore të gjykatave të rregullta.
33. Rrjedhimisht, këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës, Gjykata do e shqyrtojë dhe analizojë nga pikëpamja e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në dritën e interpretimit të nenit 6.1 të KEDNj-së, duke aplikuar parimet e përcaktuara nga GjEDNj-së, në bazë të së cilave kjo Gjykatë dhe gjykatat e rregullta në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës janë të obliguara që: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

## **I. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për shkelje të së drejtës për “vendim të arsyetuar”**

### *a) Parimet e përgjithshme*

34. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së (përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet [Hadjianastassiou kundër Greqisë](#), nr. 12945/87 Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; [Pronina kundër Ukrainës](#), nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe [Tatishvili kundër Ruisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, dhe [KI24/17](#), parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019; [KI35/18](#), parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135; dhe së fundmi [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jobankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 120).
35. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6.1 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih,



rastin e GjEDNj-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139; dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).

36. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që duhet të adresohen, dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e GjEDNj-së [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91 Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 134/1996/753/952. Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin e GjEDNj-së [Morerira Ferreira kundër Portugalisë](#), nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përmendura aty; shih edhe rastet e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137; dhe së fundmi [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jo-bankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 122).
37. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës nr. [KI72/12](#), *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; [KI135/14](#), *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; [KI87/18](#), parashtrues *“IF Skadeforsikring”*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138; dhe së fundmi rastin [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jobankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 123).

b) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

38. Referuar pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës ndërlidhet me mungesën e arsyetimit të aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, përkritazi me mos aprovimin e kërkesëpadisë së tyre për sa i përket vërtetimit të së drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues.
39. Në lidhje me këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [A.C. nr. 3543/2018] të 3 shkurtit 2022, të Gjykatës së Apelit, e cila arsyetoi: *“Gjykata e shkallës së dytë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për faktin se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për*

procedurën kontestimore, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vështron sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore. Gjendja faktike nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, mirëpo gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale dhe për këtë arsye aktgjykimi është ndryshuar dhe kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës refuzohet si e pabazuar e në bazë të nenit 195/1 nën pikën e), e lidhur me nenin 201 par.1 nën pikën d), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

[...]

Në certifikatën P-72116038-00957-0, të lëshuar me datë 04.12.2014, nga Zyra Kadastrale Komunale Suharekë, përmban të dhënat për njësinë kadastrale, dhe atë numri i njësisë kadastrale 957-0, lloji i pronës, pronë shoqërore, me sipërfaqe 260 m2, shfrytëzimi aktual i parcelës RRUGË E PAKATEGOR., vendi i quajtur "Fshat", Zona Kadastrale Samadrexhë, Komuna Suharekë.

Në nenin 11 të Ligjit për rrugët nr.2003/11, në mënyrë decitive thuhet se: "Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike".

Mbi këtë vijë argumentimi, Gjykata vë theksin edhe në arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, më të cilin u refuzua kërkesa për revizion e parashtruesve të kërkesës, si në vijim: "[...] Në kontekstin e mësipërm, paditësit nuk kanë provuar se e kanë fituar pronësinë në bazë të parashkrimit fitues (Usucapio - neni 28 i LMTHPJ-së), përkatësisht, sikundër kane pretenduar, se me mbajtje dhe posedim me mirëbesim mbi 20 vite e kanë fituar pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese.

[...]

nuk mund të bëhet fjalë për posedimin me mirëbesim e me këtë as për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues sikundër parashihet me dispozitën e nenit 28.4 të Ligjit të sipër përmendur, sipas të cilës, përveç posedimit të sendit dhe kohëzgjatjes së posedimit prej 20 viteve, kërkohet që posedimi të jetë edhe me mirëbesim, gjë që, siç u sipër theksua, këtu nuk është rast.

[...]

Në kontekstin e mësipërm, duhet pasur parasysh se edhe me dispozitën e nenit 11 të Ligjit për rrugët, nr.2003/11, parashihet se "Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike".

40. Duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata vlerëson se e njëjta në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar adresoi aspektet e rastit për sa i përket refuzimit të kërkesëpadiës së parashtruesve të kërkesës, ku konkludoi se njësia kadastrale e kontestuar figuronte si pronë shoqërore, me shfrytëzim aktual si rrugë e pa kategorizuar. Për më tepër, Gjykata e Apelit ndër arsyet specifike të vendimit të saj e bazoi edhe në nenin 11 të Ligjit për rrugët i cili në mënyrë shprehimore përcaktonte ndalesën për miratimin e bartjes së pronësisë në rrugët publike.
41. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme për sa i përket çështjes së fitimit të pronësisë me parashkrim fitues, e trajtoi posedimin me mirëbesim, ku përveç posedimit dhe kohëzgjatjes prej 20 viteve, kërkohet të përmbushej edhe elementi i mirëbesimit në përputhje të dispozitave të nenit 28 të LMTHJP-së. Përveç kësaj, Gjykata Supreme



gjithashtu përmendi edhe dispozitën e nenit 11 të Ligjit për rrugët i cili ndalonte kërkesat për pronësi në rrugët publike apo pjesët e rrugëve publike.

42. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme të GjEDNJ-së, siç janë elaboruar më lart dhe bazuar në arsyetimet e gjykatave të rregullta, vlerëson se në rastin e parashtruesve të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje të plotë me standardet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës është e qartë se vendimmarrja ishte e bazuar në prova të ndryshme, në dëshmitë e dëshmitareve dhe vlerësimet e ekspertëve. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor përkitazi me kërkesat dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës. Për rrjedhojë, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës kanë përfituar nga e drejta për të pranuar vendim të arsyetuar gjyqësor, në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
43. Në lidhje me këtë, Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksojë qëndrimin e përgjithshëm parimor se “*drejtësia*” që garantohet përmes nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik dhe në parim, kjo drejtësi procedurale shprehet përmes procedurës kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, KI131/19, parashtrues *Sylë Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 57; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55). Kjo më saktësisht nënkupton se palëve përgjatë një procedure të drejtë dhe të paanshme duhet: (i) t’u mundësohet zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit procedural; (ii) t’u ofrohet mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) t’u garantohet se të gjitha argumentet dhe dëshmitë që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat përkatëse; (iv) t’u garantohet se faktet dhe pretendimet ligjore në vendimet gjyqësore ishin shqyrtuar dhe arsyetuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, (v) t’u garantohet se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe jo arbitrare (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29; dhe rastin e Gjykatës, KI131/19, cituar më lart, paragrafi 58).
44. Gjykata arrin në përfundim se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesit e kërkesës nuk kanë argumentuar se standardet dhe garancitë e mësipërme të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me të drejtën në vendim të arsyetuar nuk janë zbatuar. Parashtruesit e kërkesës edhe më tej mund të mos jenë të kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tyre, megjithatë, kjo pakënaqësi vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e te drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së: [\*Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë\*](#), nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
45. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ky pretendim i parashtruesve të kërkesës lidhur me vendimin e paarsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, prandaj kërkesa në tërësinë e saj shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me rregullin 34 (2) të Rregullores së Punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (1)(b) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2023, njëzëri:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtarja raportuese**

  
Remzije Istrefi Peci



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka Nimani